

NË Ç 'MËNYRË DEZINFORMIMI SHËNJESTRON DHE NDIKON NË MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOSOVË?



Në ç 'mënyrë dezinformimi shënjestron dhe ndikon në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë?

Botuar nga:

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Autorët:

Ramadan Ilazi

Jeta Loshaj

Tamara Pavlović

Agnesa Bytyçi (Asistente e Hulumtimit)

Dizajni nga:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

Punimi hulumtues "Të kuptuarit se si dezinformimi shënjestron dhe ndikon në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë" zbatohet me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në Kosovë. Përmbajtja e këtij punimi hulumtues i përket Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e NDI-së dhe USAID-it.



Tabela e Përmbajtjes

Rreth autorëve	4
Gjetjet kryesore	5
Hyrje	9
Metodologjia	11
Eksplorimi i faktorëve të cenueshmërisë ndaj dezinformatave që shënjestrojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë	12
Gjysmë të vërtetat, realitetet paralele dhe dezinformatat	20
Dinamika e diasporës dhe rritja e dezinformatave	22
Të kuptuarit e dezinformatave që shënjestrojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë përmes numrave	24
Konkluzion: Ndikimi i dezinformimit në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë	30

Rreth autorëve



Dr. Ramadan Ilazi

Aktualisht shërben kryesues i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), dhe shërben si udhëheqës i ekipit në kuadër të projektit SMIDGE të financuar nga Horizon Europe, i i cili heton rritjen e narrativave ekstremiste midis individëve të moshës së mesme në Evropë. Ai është gjithashtu anëtar i Task Forcës së Ballkanit Perëndimor të Institutit Republikan Ndërkombëtar për Kërcënimet ndaj Demokracisë. Në këtë rol, ai ka qenë bashkëautor i një punimi mbi dobësitë e Kosovës ndaj ndikimit keqdashës të huaj. Nga viti 2015 deri në vitin 2016, Ramadan ka qenë zëvendësministër i Kosovës për Integritet Evropian, ku ka kontribuar në hartimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane (ERA) për Kosovën. Ai gjithashtu ka punuar si konsulent për organizata si OECD/SIGMA për reformën e administratës publike në Kosovë. Ramadani ka PhD në Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Shkolla e Drejtësisë dhe Qeverisjes së Dublin City University (DCU), Irlandë, dhe master në studime të konfliktit dhe paqes në Universitetin St. Andrews, Skoci. Libri i tij i fundit, "Bashkimi Evropian dhe shtetndërtimi i përditshëm: Rasti i Kosovës", botuar nga Routledge Studies in Statehood, shqyrton në mënyrë kritike rolin dhe veprimin e BE-së në ndërhyrjet në shtetndërtim.



Jeta Loshaj

Ka përfunduar studimet Master në fushën e studimeve të Rusisë dhe Evropës Lindore në Universitetin Indiana Bloomington në SHBA, kurse studimet Bachelor i ka përfunduar në RIT Kosova në fushën e Politikave Publike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Zj. Loshaj momentalisht punon si hulumtuese dhe bashkëpunëtore e projekteve në Qendrën Kosovare. Në të kaluarën, Zj. Loshaj ka përfunduar një program praktike në Parlamentin Gjerman, si dhe ka punuar si bashkëpunëtore për Kosovë në Këshillin për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG). Fushat e interesit për Zj. Loshaj përfshijnë politikën e jashtme me fokus ndikimin e Rusisë në Ballkanin Perëndimor, marrëdhëniet multi- dhe bilaterale të Kosovës me rajonin, BE-në, dhe SHBA-të - tema për të cilat Zj. Loshaj ka publikuar disa hulumtime. Përveç gjuhës amtare shqipe, Zj. Loshaj njeh gjuhën angleze, gjermane, dhe ruse.



Tamara Pavlovic

Është bashkëpunëtore hulumtuese në QKSS dhe e diplomuar për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin Corvinus të Budapestit, e specializuar në integrimin evropian. As Që nga viti 2023, ajo është duke ndjekur një LLM nga Universiteti i Prishtinës në të Drejtat e Njeriut, të Drejtën Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale. Puna e saj lidh kërkimin akademik dhe avokimin praktik. Tamara ka udhëhequr dhe marrë pjesë në projekte të të drejtave të njeriut në të gjithë Ballkanin, ka punuar dhe menaxhuar një mjedis ndërkombëtar, ka kontribuar në zhvillimin e politikave me ndikim dhe ka një sfond të fortë në komunikim dhe markë. Aktualisht, ajo është duke punuar si bashkëpunëtore hulumtuese në kuadër të projektit RYP.

Gjetjet kryesore

Dezinformimi është një çështje e përhapur në Kosovë, ku 66% e të anketuarve në anketën e post-fokus grupeve raportojnë se ndeshen shpesh me narrativa përçarëse. Ky mbizotërim i lartë reflekton një ekosistem të rrënjosur të dezinformimit që zhvillohet në cënueshmërinë që ka shoqëria kosovare. Dezinformimi vepron në nivele të shumta, duke shënjestëruar perceptimet individuale, dinamikën e komunitetit dhe besimin institucional. Shpesh fokusohet në çështje të ngarkuara emocionalisht dhe të ndjeshme nga ana kulturore, duke përdorur të vërteta të pjesshme dhe informacione të paverifikuara për të përkeqësuar ndarjet.

Sipas të dhënave nga sondazhi i NDI, 83% e të anketuarve besojnë se dezinformimi ka ndikim të rëndësishëm në besimin ndërmjet komuniteteve etnike në Kosovë. Kjo përputhet me gjetjet tona se dezinformimi përkeqëson stereotipet dhe thëllon mosbesimin. Perceptime të tilla të përhapura nënvizojnë nevojën urgjente për strategji të synuara për të zbutur dezinformimin dhe për të nxitur besimin ndëretnik.

Dezinformimi shpesh përforcon mosmarrëveshjet politike, historinë dhe stereotipet negative, duke i portretizuar pjesëtarët e grupeve tjera etnike si agresorë ose të rrezikshëm. Për shembull: Mediat në gjuhën serbe shpesh i paraqesin shqiptarët e Kosovës sikur synojnë të minojnë kulturën dhe identitetin serb në Kosovë. Mediat në gjuhën shqipe i portretizojnë disa serbë të Kosovës se synojnë të destabilizojnë Kosovën. Këto narrativa thellojnë mosbesimin, dekurajojnë ndërveprimet ndëretnike dhe pengojnë përpjekjet për pajtim.

Paralajmërimet për një luftë të afërt ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u qarkulluan gjerësisht në platformat e mediave sociale dhe mediave të lajmeve online, duke përkeqësuar frikën dhe pasigurinë në Kosovë. Në mënyrë alarmante, disa nga këto pretendime fituan legjitimitet përmes deklaratave të bëra nga drejtues të lartë të qeverisë së Kosovës, duke përforcuar pa dashje narrativat dezinformuese. Retorikat e tilla jo vetëm që rrisin shqetësimet në opinion, por gjithashtu ofrojnë terren të përshtatshëm për përhapjen e dezinformatave, duke destabilizuar më tej proceset tashmë të brishta

të dialogut dhe pajtimit.

Zyrtarët qeveritarë në Kosovë duhet të shfaqin një nivel më të lartë pjekurie duke u përmbajtur nga retorika që nxit konflikte dhe duke shmangur deklaratat që kontribuojnë në një atmosferë frike. Në vend të kësaj, ata duhet të fokusohen në nxitjen e paqes e qetësisë, promovimin e dialogut dhe luftimin e dezinformimit përmes komunikimit të saktë dhe të balancuar.

Mediat e polarizuara etnikisht përjetësojnë "realitete paralele", ku komuniteti shqiptar dhe serb në Kosovë konsumojnë tregime krejtësisht të ndryshme për të njëjtat ngjarje. Për shembull: mediat shqiptare mund t'i përshkruajnë veprimet e policisë në veri të Kosovës si masa të zbatimit të ligjit, ndërsa mediat serbe i përshkruajnë ato si masa qëllimisht të drejtuara kundër serbëve. Mungesa e platformave multietnike mediatike, apo prania e zërave shqiptarë dhe serbë në debatet televizive në programet e natës, apo në raportimet e lajmeve, e thëllon më tej këtë ndarje, duke parandaluar perspektivat e balancuara dhe mirëkuptimin e përbashkët. Përveç kësaj, hulumtimi i brendshëm i Institutit Kombëtar Demokratik tregon për një mosbesim të thellë në lajmet dhe informacionet që ekzistojnë në mesin e komunitetit serb që jeton në Kosovë, gjë që e ndërlikon më tej realitetin në të cilin jetojnë serbët e Kosovës.

Dezinformimi shfrytëzon narrativat kulturore dhe fetare, duke i përdorur ato si mjete për të nxitur ndarjen. Për shembull: mediat serbe i paraqesin shqiptarët e Kosovës si kërcënime ndaj objekteve fetare ortodokse. Rrëfimet rreth sulmit të vitit 2023 në Banjska, në mediat serbe paraqiten duke i lavdëruar pjesëtarët e grupit të armatosur si heronj, duke nxitur polarizimin.

Narrativat e rreme të drejtuara kundër institucioneve të Kosovës dëmtojnë besimin e publikut dhe pengojnë procesin e integritetit dhe karakterin multietnik të shtetit të Kosovës. Si shembuj mund të përmendim pretendimet se Qeveria e Kosovës po angazhohet në "spastrim etnik". Kjo dhe lajme të tjera dobësojnë besueshmërinë institucionale dhe ndërlikojnë përpjekjet për të lehtësuar dialogun e pajtimit dhe normalizimit.

Dezinformimi dekurajon bashkëpunimin ndëretnik duke krijuar një mjedis armiqësor për dialog. Për shembull: Narrativat rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (AKS) e cilësojnë atë si një kërcënim për integritetin territorial dhe sovranitetin, gjë që çon në kundërshtimin e shqiptarëve të Kosovës. Mediat serbe e portretizojnë mungesën e progresit të AKS-së si dëshmi të vullnetit të keq të Kosovës, duke nxitur mosbesimin tek serbët. Një nga narrativat kryesore në lidhje me AKS-në është se “formimi i AKS-së do të nënkuptonte formimin e një Republika Srpska tjetër në Kosovë”, gjë që besohet nga 58% e shqiptarëve dhe 37% e serbëve të Kosovës.

Dezinformatat rreth incidenteve të mëdha, siç ishte sulmi terrorist i Banjskës në shtator të vitit 2023, përkeqësojnë më tej ndarjet dhe dëmtojnë besimin në dialog dhe përpjekjet e pajtimit. Mediat serbe i glorifikuan pjesëtarët e grupit të armatosur të përfshirë në sulm, duke i cilësuar ata si “heronj”, duke keqinterpretuar e shtrembëruar numrin e viktimave dhe operacionet e Policisë së Kosovës në veri në përgjithësi. Këto narrativa, të nxitura nga motive politike dhe të ushqyera nga dezinformatat, polarizojnë komunitetet dhe pengojnë përparimin drejt normalizimit dhe bashkëpunimit ndëretnik.

Sipas diskutimeve në fokus grupe dhe intervistave me zyrtarë të lartë të qeverisë nga komunat me shumicë serbe, sugjerohet se, ndërkohë që platformat e mediave sociale dhe portalet e lajmeve online janë burimi kryesor i dezinformimit, thashethemet lokale ose fjalët bartur gojë më gojë shërbejnë si përforcues joformal të dezinformimit, shpesh duke u përhapur në mjediset e zakonshme si kafenetë apo mbledhjet e komunitetit. Në nivelin lokal, thashethemet lokale ose fjalët bartur gojë më gojë mund të kenë efekte shkatërruese. Për shembull: Në Graçanicë, vjedhjet brenda grupeve etnike i janë m’veshur gabimisht komuniteteve tjera, duke përforcuar stereotipet dhe mosbesimin. Këto thashetheme fitojnë peshë për shkak të ndarjes shoqërore dhe fizike midis grupeve etnike, ku ndërveprimi i kufizuar forcon mbështetjen në thashethemet.

Në këtë mjedis kaotik të tensioneve të shtuara dhe dezinformimit të papërmbajtur, shqetësimet legjitime dhe rastet e mundshme të dhunës kundër komunitetit serb të Kosovës në veri mbesin nën hije. Dezinformatat e përhapura, si dhe mungesa e konsultimit dhe koordinimit nga qeveria e Kosovës për veprimet e zbatuara në veri të Kosovës,

ndihmojnë në marginalizimin e zërave liberalë dhe pjesëtarëve të komunitetit serb që avokojnë për integrim dhe shoqëri multietnike në Kosovë. Këto tensione krijojnë një mjedis ku përpjekjet për të promovuar dialogun, besimin dhe pajtimin mbyten nga narrativat përçarëse. Shoqëria civile në Kosovë, por veçanërisht ato aktive në veri, kanë një rol vendimtar në kapërcimin e këtij hendeku duke komunikuar në mënyrë konstruktive shqetësimet e komunitetit, siç bëjnë shpesh. Megjithatë, pa mbështetje të koordinuar institucionale dhe masa për të luftuar dezinformimin, këto përpjekje rrezikojnë të mbesin në errësirë, duke minuar vizionin e një shoqërie kohezive dhe multietnike në Kosovë.

Nivelet e ulëta të edukimit mediatic përkeqësojnë ndikimin e dezinformimit. Shumë individëve u mungojnë aftësitë për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin që konsumojnë, duke i bërë ata më të përshtatshëm ndaj manipulimit. Ndërlidhja e platformave mediatike digjitale dhe tradicionale lejon që narrativat e rreme të fitojnë legjitimitet, duke arritur tek audiencia e cila përndryshe do mund të mbështetej në burime të besueshme.

Gjetjet e sondazhit të NDI Kosovë zbulojnë një boshllëk kritik në praktikën efektive të kontrollit të fakteve, pasi individët në masë të madhe mbështeten në rrjetet joformale, si familja dhe miqtë, për të verifikuar informacionin (31%), dhe jo në burime profesionale apo të besueshme. Përderisa 46% e të anketuarve u drejtohen mediave të tjera, ku mbështetja e konsiderueshme në rrjetet personale dhe mediat sociale (me 12%) pasqyron një mjedis ku përforcohen thashethemet dhe narrativat e paverifikuara. Vetëm 11% i japin përparësi kontrollit të burimit origjinal të informacionit, duke nënvizuar mungesën e qasjes kritike me përmbajtjen që konsumohet. Kjo sjellje jo vetëm që e mirëmban përhapjen e dezinformatave, por gjithashtu thekson rolin e komunikimit informal të bazuar në komunitet në vërtetimin dhe përforcimin e narrativave të rreme.

Mbështetja e familja dhe miqtë, megjithëse rrënjësor në besim, mund të përforcojë pa dashje keqinformimin dhe dezinformimin, veçanërisht në një kontekst shumë të polarizuar si Kosova ku marrëdhëniet ndëretnike janë të brishta. Kjo gjithashtu përputhet me vëzhgimin më të gjerë në këtë raport se thashethemet lokale shërbejnë si përforcues joformal të dezinformatave, duke krijuar një unazë reagimi përforcues që minon besimin dhe nxit tensionet ndëretnike.

Gjuha si një pengesë për ndërtimin e marrëdhënieve dhe të kuptuarit e njëri-tjetrit, mungesa e komunikimit dhe hezitimi për të promovuar rrëfime pozitive luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në lehtësimin e dezinformimit për të depërtuar përmes ndjeshmërisë së realitetit në terren. Megjithatë, edhe pse gjuha vazhdon të jetë një pengesë, ka rrëfime pozitive që jo gjithmonë, nëse ndonjëherë, përbëjnë edhe vetë lajm. Ekspozimi më i madh i rrëfimeve pozitive ku ka komunikim dhe mirëkuptim, si dhe zgjidhja e incidenteve me bazë etnike do të shërbente si një kundërmasë ndaj përpjekjeve për dezinformim.

Komunitetet e marginalizuara dhe ato rurale janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dezinformimi për shkak të aksesit të kufizuar në arsim dhe burime informacioni. Kjo dobësi nënvizon nevojën për ndërhyrje të synuara. Komunitetet e diasporës i zmadhojnë dezinformatat, shpesh duke adoptuar narrativa më radikale. Për shembull: rrjetet e diasporës serbe shpërndajnë pretendime për armiqësinë e Kosovës ndaj serbëve. Disa rrjete të diasporës shqiptare përforcojnë narrativat duke e cilësuar dialogun e normalizimit të marrëdhënieve si koncesion për Serbinë. Këto dinamika nxisin polarizimin dhe komplikojnë perceptimet ndërkombëtare për Kosovën.

Çfarë mund të bëhet?

- > Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë urgjentisht iniciativa mbarëkombëtare për edukimin mediatic në shkolla dhe komunitete për të fuqizuar qytetarët që të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin dhe t'i rezistojnë dezinformatave.
- > Zyra për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit duhet të marrë mbështetje të synuar për zhvillimin e kapaciteteve për të thelluar të kuptuarit e praktikave dhe taktikave të dezinformimit. Kjo duhet të përfshijë asistencën teknike nëpërmjet ekspertizës dhe trajnimit për identifikimin dhe luftimin e çrregullimeve të informacionit duke ruajtur një angazhim për transparencë dhe saktësi. Për më tepër, Zyra për Komunikim me Publikun e ZKM-së duhet të ketë prioritet komunikimin proaktiv dhe transparent me publikun, veçanërisht për zhvillimet në veri të Kosovës dhe dialogun për normalizim e marrëdhënieve me Serbinë. Gjetjet tona tregojnë se transparenca e pamjaftueshme

e qeverisë dhe shpërndarja e kufizuar e informacionit të saktë për veprimet e qeverisë në veri dhe zhvillimet e përgjithshme atje krijojnë terren të përshtatshëm për dezinformim. Duke adresuar këto mangësi, Zyra për Komunikim mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit të publikut dhe të zbusë ndikimin e narrativave të rreme.

- > Zyra për Komunikim me Publikun duhet të zgjerojë aktivitetet e saj të komunikimit me mediat në gjuhën serbe në Kosovë për të nxitur angazhim dhe besim më të madh. Përveç kësaj, Zyra duhet të sigurojë gjithëpërfshirjen në Kosovë.
- > Serbët në ekipin e ZKM-së, nëse nuk e kanë bërë tashmë, mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe lidhjen e mirëkuptimit kulturor dhe gjuhësor. Kjo përfshirje do të forconte zotësinë e Zyrës për të komunikuar në mënyrë efektive veprimet dhe politikatat e qeverisë me komunitetin serb në Kosovë, duke rritur kështu transparencën dhe duke reduktuar ndjeshmërinë e këtij komuniteti ndaj dezinformatave.
- > Me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të transmetuesit publik (RTK) për të luftuar dezinformimin dhe për të promovuar saktësinë faktike, Ligji për RTK-në duhet të ndryshohet ose të krijohet një politikë e re nga Bordi i RTK-së për të themeluar një departament të dedikuar për verifikimin e fakteve. Ky departament do të fokusohet në verifikimin e narrativave publike, veçanërisht atyre që prekin marrëdhëniet ndëretnike, por edhe verifikimin e lajmeve nga RTK-ja para se të publikohen.
- > Qeveria e Kosovës duhet të përpiqet të krijojë bashkëpunim me platformat e mediave sociale si Facebook, X dhe Google, dhe të autorizojë një dokument gjithëpërfshirës të politikave që synon përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së platformave të mediave sociale në Kosovë. Ky dokument duhet të shqyrtoj mekanizmat për nxitjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe kompanitë e mediave sociale për të siguruar transparencë dhe akses më të madh të të dhënave të platformës për publikun dhe studiuesit. Kjo është në pajtim me Aktin e Përgjegjshmërisë dhe Transparencës së Platformës (PATA) i propozuar në Shtetet e Bashkuara si një ligj i mbështetur nga të dy partitë. Një kornizë e tillë ligjore do të kërkonte

që kompanitë e mediave sociale të ndajnë të dhëna kritike me publikun dhe studiuesit, duke siguruar llogaridhënie pa cenuar privatësinë e përdoruesit. Kjo iniciativë duhet të zhvillohet në konsultim të ngushtë me Komisionin Evropian për të përafuar me angazhimet e Kosovës sipas EU Acquis dhe për të siguruar përputhshmëri me standardet dhe praktikën e BE-së për qeverisjen digjitale. Angazhimi i gjerë i palëve

të interesuara, duke përfshirë konsultimet me shoqërinë civile, pedagogë universitar dhe organizatat mediatike, duhet të jetë qenësor në procesin e hartimit për të siguruar gjithë përfshirje dhe pajtim për parimet demokratike.

Hyrje

Dezinformimi dhe keqinformimi janë çështje të përhapura në Kosovë, ku shfrytëzojnë ndarjet ekzistuese shoqërore dhe besimin e ulët në të dhënat institucionale. Pjesëmarrësit në fokus grupe dhe intervista kryesisht e përkufizuan keqinformimin si pasaktësi të paqëllimshme ose të vërteta të pjesëshme të përhapura për shkak të keqkuptimit ose mungesës së verifikimit, ndërsa dezinformimi shihej si informacion mashtrues qëllimisht i krijuar për të krijuar ndarje.¹ Edhe pse informimi keqdashës/malicioz nuk u diskutua, dallimi në mes të keqinformimit dhe dezinformimit nxjerr në pah natyrën e qëllimshme të këtij të fundit në destabilizimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Sipas sondazhit të fundit të NDI në Kosovë, 67% e serbëve të Kosovës besojnë se gjërat po shkojnë në drejtimin e gabuar, ndërsa 41% e shqiptarëve të Kosovës besojnë të kundërtën. Serbët e Kosovës kanë prioritet papunësinë (66%) dhe tensionet ndëretnike (49%) si çështjet e tyre kryesore, kurse shqiptarët fokusohen më shumë në papunësinë (77%) dhe korrupsionin (56%). Ekziston dallimi konsiderueshëm në perceptimet e marrëdhënieve ndëretnike, deri sa 65% e serbëve të Kosovës presin që marrëdhëniet të përkeqësohen, 53% e shqiptarëve të Kosovës janë optimistë për përmirësim. Konsumi mediatic është i segmentuar shumë sipas përkatësisë etnike me 79% të serbëve të Kosovës që mbështeten çdo ditë në stacionet televizive serbe, me 66% që shprehin besim në këto media. Të anketuarit shqiptarë të Kosovës kryesisht përdorin stacionet televizive të Kosovës (86%) dhe mediat sociale (50%) si burime informacioni. Besimi në burimet e informacionit mbetet i ulët midis grupeve etnike, me mbështetjen në rrjetet personale (miqtë dhe familja) të zakonshme për verifikimin e fakteve.² Komuniteti serb i Kosovës beson gjerësisht në narrativat e dezinformatave, siç janë pretendimet për plane të spastrimit etnik dhe keqtrajtimi nga Policia e Kosovës gjatë incidenteve si sulmi terrorist

në Banjska. Në mesin e shqiptarëve të Kosovës, skepticizmi rreth këtyre narrativave është më i lartë, duke reflektuar polarizimin etnik.

Një faktor i rëndësishëm që mundëson si keqinformimin ashtu edhe dezinformimin është skepticizmi ndaj narrativave institucionale – qoftë nga qeveria, organizatat ndërkombëtare apo mediat kombëtare. Këto institucione përgjithësisht shihen si të njëanshme ose të drejtuara me agjendë të caktuar, jashtë sinkronizimit me prioritetet e komuniteteve lokale. Anasjelltas, mbështetja në burime të njohura, siç janë mediat lokale të lajmeve të ndara etnikisht dhe komunikimi përmes thashethemeve, përkeqëson ndarjen dhe mosbesimin. Këto burime, megjithëse perceptohen si të ngjashme dhe që veprojnë në interesin më të mirë të komunitetit, shpesh janë të njëanshme, jo të plota ose të pasakta, duke përforcuar më tej kuvendimet me mendime të njëjta në komunitet.

Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës shpesh manipulohen përmes dezinformatave për të nxitur mosbesimin. Veprimet e Qeverisë së Kosovës që prekin komunitetin serb – siç është mbyllja e institucioneve – në mediat serbe prezantohen si diskriminim etnik apo edhe “spastrim etnik”. Në mënyrë të ngjashme, raportet e pakontekstualizuara ose të ofruara në mënyrë senzacionale për ngjarjet në kaluarën, si pretendimi i sajuar i mbyljes në ujë të fëmijëve shqiptarë nga serbët, vazhdojnë të ndezin armiqësinë etnike. Këto narrativa shfrytëzojnë historinë e pazgjidhur, duke përforcuar pakënaqësitë që pengojnë përpjekjet për pajtim.

Vështirësitë socio-ekonomike, të tilla si nivelet e larta të varfërisë dhe mangësitë e punësimit, rrisin ndjeshmërinë ndaj dezinformimit Sipas Indeksit të cënueshmërisë Democracy Plus 2024, i cili pa rezultatin e cënueshmërisë së Kosovës të rritet nga 41 në 57, paqëndrueshmëria ekonomike i bën individët më të ndjeshëm ndaj dezinformatave të ngarkuara emocionalisht.³ Qasja e kufizuar

1. Për më shumë lexo “Raporti i Çrregullimeve të Informacionit në Kosovë 2023”, <https://www.ndi.org/publications/information-disorders-kosovo-2023-report>

2. Hulumtimi Kombëtar i Opinioneve Publike, NDI, 2024

3. DPlus, “Indeksi i 2-të i cënueshmërisë ndaj dezinformimit në Kosovë”, qershor, 2024, <https://dplus.org>

në arsim cilësor dobëson të menduarit kritik dhe edukimin mediatik, duke i bërë që shumë individë të mos jenë të aftë të identifikojnë informacionin e njëanshëm. Instituti Kombëtar Demokratik në raportin e tij për Integritetin e Informacionit në Kosovë, Vlerësimi i Ekonomisë Politike të Dezinformatave (korrik 2022) gjeti se sistemi arsimor i përgatit në mënyrë të pamjaftueshme qytetarët për vlerësimin e dezinformatave online, duke rritur më tej cenueshmërinë.⁴

Çështja e dezinformimit nuk është thjesht një sfidë e ekosistemeve moderne të informacionit; është një strategji e qëllimshme e përdorur nga akterë të brendshëm dhe të jashtëm për të destabilizuar komunitetet dhe për të minuar qeverisjen demokratike. Përderisa platformat digjitale zgjerojnë aksesin në informacion, ato gjithashtu lehtësojnë përhapjen e shpejtë të narrativave të rreme, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë për komunitetet të dallojnë faktin nga trillimi. Ky raport trajton këto sfida me fokus në implikimet e tyre në marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Ky raport bazohet në hulumtime cilësore, duke përfshirë njohuri nga dy burime parësore: Dy diskutime në fokus grupe u zhvilluan me gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës, të përbërë nga kombinimi i shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Këto diskutime siguruan një perspektivë bazë se si dezinformimi ndikon në dinamikën ndëretnike, duke eksploruar përvojat e përjetuara, perceptimet dhe sfidat e nivelit të komunitetit. Për më tepër, nëntë intervista të thelluara u kryen me një gamë të ndryshme të palëve të interesuara, duke përfshirë ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, përfaqësues nga shoqëria civile dhe zyrtarë qeveritarë. Këto intervista ofruan njohuri ekspertësh për dimensionet strukturore, kulturore dhe politike të

dezinformimit në Kosovë.

Kombinimi i këtyre qasjeve ofron një kuptim të nuancuar të problemit, duke kapur si prirjet e nivelit makro ashtu edhe përvojat e nivelit mikro. Gjetjet janë kontekstualizuar brenda literaturës ekzistuese dhe plotësohen me të dhëna statistikore nga anketat dhe studimet e mëparshme.

Raporti është i strukturuar siç vijon: Një analizë e detajuar e temave dhe njohurive kryesore që dolën nga fokus grupet dhe intervistat, duke theksuar ndikimin e dezinformatave në marrëdhëniet ndëretnike, besimin institucional dhe përpjekjet për pajtim. Seksioni vijues shqyrton faktorët strukturorë, kulturorë dhe politikë që e bëjnë Kosovën veçanërisht të ndjeshme ndaj dezinformimit. Këtu përfshihen gjithashtu edhe përmbledhja e metodave dhe rrëfimeve kryesore të përdorura në fushatat e dezinformimit, duke përfshirë rolet e mediave, aktorëve politikë dhe komunitetit të diasporës. Një vlerësim se si dezinformimi ndikon në dinamikën e komunitetit, ruan stereotipet dhe minon nismat për ndërtimin e paqes.

Përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë e bëjnë veçanërisht të theksuar çështjen e dezinformimit. Dezinformimi jo vetëm që mban gjallë ndarjen, por edhe minon besimin në institucionet dhe përpjekjet ndërmjetësuese për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Duke trajtuar mekanizmat dhe ndikimet e dezinformimit, ky raport synon të kontribuojë në një kuptim më të thellë se si të kundërvihet më mirë dezinformata që synon marrëdhëniet ndëretnike, në mënyrë që të nxisë një shoqëri kohezive dhe demokratike.

Gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura këtu synojnë të shërbejnë si burim për politikëbërësit, organizatat e shoqërisë civile, punonjësit e mediave dhe aktorët ndërkombëtarë që punojnë për të promovuar paqen dhe pajtimin në Kosovë. Në thelb të tij, ky raport thekson rëndësinë e nxitjes së qëndrueshmërisë ndaj dezinformatave ku marrëdhëniet ndëretnike karakterizohen nga besimi, bashkëpunimi dhe respekti reciprok.

[org/wp-content/uploads/2024/07/25-07-2024_Index-of-Disinformation.pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/Information%20Integrity%20in%20Kosovo%20-%20Assessment%20of%20the%20Political%20Economy%20of%20Disinformation.pdf)

4. NDI Kosovë, "Integriteti i informacionit në Kosovë Vlerësimi i ekonomisë politike të dezinformimit", korrik 2022,, <https://www.ndi.org/sites/default/files/Information%20Integrity%20in%20Kosovo%20-%20Assessment%20of%20the%20Political%20Economy%20of%20Disinformation.pdf>

Metodologjia

Ky raport përdor një qasje me metoda të përziera për të eksploruar se si dezinformimi ndikon në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, duke e eksploruar këtë çështje nga perspektiva të shumta. Metodologjia përfshin mbledhjen dhe analizën cilësore dhe sasiore të të dhënave, duke kombinuar diskutimet në fokus grupe, intervista të thella, anketa dhe analiza dokumentesh.

- > **Diskutimet në fokus grupe:** Dy diskutime në fokus grupe u zhvilluan më 9 dhe 10 tetor 2024, me gjithsej 15 pjesëmarrës në secilin grup. Grupi i parë përbëhej nga të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës, duke ofruar njohuri se si dezinformimi ndikon në perceptimet dhe ndërveprimet e të rinjve. Grupi i dytë përbëhej nga ekspertë, duke përfshirë profesorë universitar, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë, duke ofruar një perspektivë më analitike mbi ndikimet strukturore dhe shoqërore të dezinformimit. Të dy diskutimet u fokusuan në përvojat e përjetuara, perceptimet e dinamikës ndëretnike dhe zgjidhjet e mundshme.
- > **Intervista të thelluara:** Gjatë tetorit dhe nëntorit 2024 u zhvilluan nëntë intervista personale me një gamë të larmishme palësh të interesuara. Këtu përfshiheshin zyrtarë të qeverisë së Kosovës, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare (si nga Këshilli i Evropës), zyrtarë të pushtetit lokal, gazetarë dhe ekspertë të shoqërisë civile. Këto intervista dhanë njohuri të detajuara mbi mekanizmat dhe pasojat e dezinformimit, si dhe përgjigjet dhe sfidat institucionale në adresimin e tij.
- > **Ndërmjet datave 1 dhe 15 tetor 2024,** QKSS realizoi një sondazh të shkurtër online pas diskutimeve për të mbledhur perceptime të menjëhershme pas sesioneve të focus grupit. Ky sondazh përfshinte gjithsej 35 respondentë, duke përfshirë disa pjesëmarrës të focus grupit, disa individë jo-pjesëmarrës, si dhe një numër të vogël studentësh dhe të rinjsh të përzgjedhur rastësisht. Është e rëndësishme të theksohet se ky sondazh nuk ishte krijuar për të matur opinionin e gjerë publik apo për të ofruar një mostër plotësisht përfaqësuese. Përkundrazi, qëllimi kryesor ishte se si pjesëmarrësit dhe

një grup i kufizuar respondentësh shtesë e perceptuan dhe interpretuan përmbajtjen e diskutimit në kohë reale. Fokusi ishte tek reagimet e menjëhershme dhe pikëpamjet subjektive, për të plotësuar të dhënat cilësore nga focus grupet me një përmbledhje të shkurtër se si temat e caktuara u kuptuan ose përjetuan nga individë jashtë sesioneve fillestare. Lidhur me të dhënat demografike—si mosha, etnia dhe gjinia—ne vendosëm qëllimisht të mos i mbledhim këto të dhëna për dy arsye kryesore. Së pari, interesi ynë ishte kryesisht të kuptonim perspektivat cilësore në lidhje me temat e diskutimit, dhe jo të lidhim përgjigjet me variabla specifike demografike. Së dyti, synuam që sondazhi të ishte i shkurtër dhe jo-intruziv, duke shpresuar të inkurajonim përgjigje të sinqerta. Si rrjedhojë, edhe pse e njohim vlerën e të dhënave demografike në disa kontekste kërkimore, ato u konsideruan jashtë fushës së qëllimeve të këtij sondazhi të veçantë. Synimi i përgjithshëm ishte të kuantifikonim perspektivat në një mënyrë të kufizuar por të fokusuar, dhe jo të ofronim një analizë statistikore të një popullsie të përgjithshme.

- > **Analiza e dokumenteve:** Hulumtimi përfshinte analizimin e raporteve dhe literaturës ekzistuese mbi dezinformimin në Kosovë, duke përfshirë të dhënat cilësore dhe sasiore nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) dhe studime të tjera relevante. Kjo analizë i ka kontekstualizuar gjetjet brenda trendeve më të gjera rajonale dhe globale, duke ofruar një bazë për identifikimin e modeleve dhe sfidave unike në Kosovë.
- > **Trekëndëshimi i të dhënave:** Për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve, të dhënat nga focus grupet, intervistat, sondazhet dhe analiza e dokumenteve janë kryqëzuar kundrejt njëri me tjetrin. Ky trekëndëshim lejoi një njohje më të mirë të ndikimit të dezinformimit në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndihmoi në identifikimin e fushave kryesore për ndërhyrje.

Duke integruar këto metoda, raporti ofron analiza dhe diskutime se si dezinformimi i përqëson ndarjet dhe minon dialogun dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë.

Eksplorimi i faktorëve të cenueshmërisë ndaj dezinformatave që shënjestrojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë

Gjendja e brishtësisë së marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë i bën ato veçanërisht të cenueshme ndaj dezinformatave

Marrëdhëniet ndëretnike të Kosovës, veçanërisht ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës janë të rrënjësura thellë në ankesat e pazgjidhura, duke krijuar një mjedis të pasigurt ku dezinformimi vetëm përparon. Efektet e vazhdueshme të luftërave të viteve të nëntëdhjeta, mungesa e drejtësisë tranzicionale dhe përpjekjet e kufizuara për pajtim i kanë lënë të dyja komunitetet me nivele relativisht të ulëta të besimit të ndërsjellë. Ekspertët e shoqërisë civile, duke u fokusuar në brishtësinë përmes gjetjeve të Indeksit të Cenueshmërisë nga Democracy +, ku marrëdhëniet ndëretnike u identifikuan si domeni më i cenueshëm shoqëror.⁵ Dezinformimi i shfrytëzon më tej këto pika të cenueshme duke mbjellë frikë dhe mosbesim midis komuniteteve. Albana Rexha, analiste e lartë e politikave në Democracy Plus thekson se akterët e jashtëm, veçanërisht Serbia dhe Rusia, janë akterët kryesorë në shpërndarjen e narrativave të rreme që i shënjestrojnë serbët e Kosovës.⁶ Këto fushata janë të dizajnuara për të minuar besimin në institucionet e Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës. Për shembull, çdo masë apo ndërhyrje e qeverisë së Kosovës në veri paraqitet nga mediat serbe, si lëvizje për "shpërnguljen e serbëve nga Kosova". Fushatat dezinformuese që synojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, i shërbejnë një qëllimi të veçantë kur bëhet fjalë për serbët e Kosovës, që është t'i bindin ata se "institucionet e Kosovës janë kundër tyre". Kjo cenueshmëri është përkeqësuar si nga qasja konfrontuese e Qeverisë së Kosovës ndaj BE-së dhe SHBA-së kur bëhet fjalë për koordinimin e veprimeve në veri të Kosovës dhe paaftësia e institucioneve

të Kosovës për t'iu kundërvënë këtyre narrativave në mënyrë efektive, duke i lënë serbët e Kosovës më të ndjeshëm ndaj dezinformatave të jashtme. Mungesa e një strategjie koherente komunikimi ose masave aktive të pajtimit lejon që këto fushata të zënë rrënjë, duke përjetësuar një cikël mosbesimi që pengon përparimin në ndërtimin e një shoqërie të përbashkët.

Dezinformimi në Kosovë përforcon ndarjet etnike duke armatosur narrativat kulturore dhe ndikimin e jashtëm

Fushatat e dezinformimit në Kosovë shpesh synojnë ndjeshmërinë dhe identitetin kulturor, duke i përdorur ato si mjete për thellimin e ndarjeve etnike. Mediat serbe shpesh i portretizojnë shqiptarët e Kosovës si kërcënim për trashëgiminë serbe, veçanërisht për objektet fetare ortodokse. Ky narrativ shpesh tenton të jetë i motivuar politikisht, duke synuar t'i pasqyrojë shqiptarët e Kosovës si agresorë të përhershëm në sytë e serbëve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar. Përdorimi i dezinformatave për të përforcuar ndarjet kulturore dhe fetare pasqyron synimet më të gjera të aktorëve të jashtëm, veçanërisht Ruisë, për të nxitur një imazh të Kosovës si në thelb të paqëndrueshme dhe për të dobësuar kohezionin shoqëror të Kosovës. Në këtë kontekst, platformat e mediave sociale janë kanalet kryesore për këto përpjekje, ku narrivat përhapen lehtësisht dhe shpesh kalojnë të pakontrolluara. Përveç narrativave kulturore, elita politike e Serbisë manipulon ngjarjet për t'i shërbyer agjendës së tyre. Për shembull, pjesëtarët e grupit të armatosur që organizuan sulmin terrorist në Banjskë në shtatorin e vitit 2023, u raportuan në disa nga mediat kryesore në Serbi si "heronj".⁷ Ky interpretim krejtësisht i

5. <https://disinformationindex.dplus.org/en/reports> fq. 10

6. Intervistë me Albana Rexhën, Zyrtare e Lartë e Politikave në Democracy Plus

7. Përparim Isufi Prishtinë "Kosova ndalon kanalet televizive sportive të Serbisë për shkak të mesazheve që 'glorifikojnë' sulmin e Banjskës" BIRN, 5 tetor 2023,

ndryshëm, i nxitur nga dezinformata, jo vetëm që polarizon komunitetet, por gjithashtu gërryen besimin në proceset e dialogimit dhe përpjekjet e pajtimit. Për të kundërshtuar një fortifikim të tillë të kulturës dhe historisë, Kosova duhet të investojë më shumë burime në mekanizmat institucionalë për të monitoruar dhe luftuar dezinformimin, për të promovuar narrativa të sakta dhe për të nxitur dialogun ndëretnik. Pa këto masa, përdorimi i vazhdueshëm i dezinformatave si një mjet për ndarje do të vazhdojë të dëmtojë si procesin e normalizimit ashtu edhe përpjekjet për ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe multietnike.

Monitorimi i platformave të mediave sociale dhe mediave online nga NDI zbulon çrregullime të përhapura të informacionit që mund të nxisin panik masiv dhe dhunë ndaj mekanizmave të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Për shembull, në disa raste pretendimet e rreme se policia e Kosovës ka rrëmbyer qytetarë të kombësisë serbe të Kosovës dhe i cilësoi në mënyrë të rreme si terroristë, kishte marr shtrirje të gjerë në opinion. Në mënyrë të ngjashme, akuzat e pabaza sugjeruan se Policia e Kosovës mund të organizonte operacione të inskenuara në veri. Paralajmërimet për një luftë të afërt ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kishin qarkulluar gjerësisht, ku disa nga këto pretendime, për fat të keq, fituan legjitimitet përmes deklaratave të bëra nga udhëheqës të lartë të qeverisë së Kosovës. Monitorimi i NDI-së tregon gjithashtu se mediat e shkruara në gjuhën serbe publikuan tituj provokues, duke i portretizuar policët e Kosovës si "terroristë" me arsyetim si përpjekje për të justifikuar dhunën ndaj policisë së Kosovës. Ishte përhapur gjerësisht keqinformimi për një sulm të dhunshëm të koordinuar në të cilin ishte përfshirë edhe policia e Kosovës. Ndër gënjeshttrat më të zakonshme në mediat shqiptare dhe serbe, ishin pretendimet e ekzagjeruara për numrin e përgjithshëm të viktimave në rastin e sulmeve terroriste në Banjskë. Për më tepër, narrativat mashtruese u përhapën rreth operacioneve të policisë pas arrestimeve, duke përfshirë pretendime të pabaza për lëvizjet dhe synimet e policisë. Disa burime, pa prova të qarta, akuzuan Policinë e Kosovës për planifikim për të sulmuar banorët vendas. Narrativet kishin dallime të konsiderueshme ndërmjet mediave në gjuhën serbe

dhe shqipe. Mediat serbe fajësuan kryeministrin Kurti për dhunën e ushtruar, duke i portretizuar veprimet e tij si diskriminuese ndaj komunitetit serb. Ata i glorifikuan edhe sulmuesit, duke i quajtur dëshmorë të vrarët, duke arsyetuar vrasjen e policit të Kosovës. Në anën tjetër, narrativat në gjuhën shqipe dhunën ia atribuuan qeverisë serbe, duke i etiketuar sulmuesit si terroristë dhe kriminelë.

Sipas një serbi të Kosovës të intervistuar për këtë raport, narrativat e dezinformatave kanë gjithmonë në fokus e kanë historinë, dhe rrëfimet e tilla nuk janë thjesht relikte të së kaluarës, por ridizajnohen për të mbështetur tensionet e vazhdueshme, shpesh me motive të drejtpërdrejta politike. Dezinformimi e shfrytëzon këtë dinamikë duke i përfshirë incidentet e përditshme përmes një pasqyrimi etnik, duke i kthyer keqkuptimet e vogla në ngjarje nxitëse. Për shembull, një rast që përfshinte një telefon të humbur u përshkallëzua në një konflikt më të gjerë midis një djali shqiptar dhe një familjeje serbe për shkak të raportimit të gabuar.⁸ Incidente të tilla ilustrojnë se si dezinformimi përforcon ndarjet etnike, duke parandaluar pajtimin kuptimplotë dhe duke nxitur një klimë ku mosbesimi bëhet vetë-përforcues.

Dezinformimi thellon frikën dhe izolimin tek serbët e Kosovës

Dezinformimi në Kosovë shpesh është i dizajnuar për të shfrytëzuar besimin tashmë të brishtë brenda shoqërisë, veçanërisht duke shënjestruar serbët e Kosovës. Narrativat e sponsorizuara nga shteti serb fokusohen në portretizimin e Qeverisë së Kosovës si armiqësore dhe shtypëse.⁹ Kjo nuk është thjesht retorikë, por një përpjekje e qëllimshme për të nxitur frikë dhe pasiguri. Për shembull, narrativat që sugjerojnë se qeveria e Kosovës po ndjek politikën "e spastrimit etnik" ose mbylljen e shkollave dhe spitaleve serbe janë të ngarkuara emocionalisht dhe shumë efektive në largimin e serbëve të Kosovës. Siç shpjegohet nga një zyrtar i Qeverisë së Kosovës: "Një familje që ik përhap panik tek miqtë dhe familjet e tij ... është si me grabit bankën e me ik".¹⁰ Kjo

<https://balkaninsight.com/2023/10/05/kosovo-bans-serbia-sport-tv-channels-over-messages-glorifying-banjska-attack/>

8. Intervistë me një zyrtar të lartë nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, tetor, 2024.

9. Intervistë me një zyrtar të lartë nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, tetor, 2024.

10. Intervistë me një zyrtar të Qeverisë së Kosovës, tetor 2024

tregon se dezinformatat që synojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë synojnë të nxisin potencialisht migrimin, duke përkeqësuar izolimin demografik të komunitetit serb. Kjo klimë frike jo vetëm që destabilizon marrëdhëniet ndëretnike, por gjithashtu dobëson strukturën e identitetit multi-etnik të Kosovës. Ndërsa familjet largohen dhe komuniteti zvogëlohet në numër, perspektivat për dialog dhe normalizim zvogëlohen, duke e lënë popullsinë e mbetur më të cënueshme ndaj fushatave të ardhshme të dezinformimit. Efekti kumulativ është një shoqëri e fragmentuar ku bashkëjetesa bëhet gjithnjë e më e vështirë, duke minuar stabilitetin afatgjatë dhe përpjekjet për ndërtimin e paqes.

Mungesa e edukimit mediatik dhe informativ e përkeqëson ndikimin e dezinformimit në Kosovë

Mungesa e edukimit mediatik dhe informativ e përkeqëson ndikimin e dezinformimit në Kosovë. Përhapja e dezinformative në Kosovë përforcohet nga nivelet e ulëta të edukimit mediatik, veçanërisht në mesin e komuniteteve të marginalizuara. Zyrtarët qeveritarë të intervistuar enkas për këtë raport argumentojnë se dezinformimi shpesh ka sukses sepse individëve u mungojnë aftësitë për të vlerësuar në mënyrë kritike përmbajtjen që ju servohet, gjë që ata e pohojnë se “është veçanërisht e vërtetë për adoleshentët, por në fakt vlen për të gjithë”. Konsumimi i shpejtë i përmbajtjes digjitale, veçanërisht në platforma si Instagram ose TikTok, i lë individët të prekshëm ndaj manipulimit përmes falsifikimit të thellë dhe formave të tjera të mashtrimit. Me fjalë të tjera, dezinformimi në Kosovë përdor ndërlidhjen e platformave mediatike digjitale dhe tradicionale për të rritur ndikimin e tij. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës janë të shqetësuar sepse, siç sqarojnë ata, “çfarë shkon në një platformë digjitale bëhet lajm në një platformë tjetër, madje edhe pamjet e Instagramit shfaqen në uebsajtin e BBC-së.”¹¹ Ky turbullim i kufijve lejon që përmbajtjet e paverifikuara ose mashtruese të fitojnë legjitimitet, duke prekur masën e publikut që përndryshe mund të mbështetet në mediat tradicionale për informacion të saktë. Kjo përzjerje e lojërave e përkeqëson çështjen e dezinformimit, veçanërisht në kontekstet ndëretnike, pasi shumëfishon kanalet

11. Ibid.

përmes të cilave përhapen narrativat përçarëse. Për shembull, imazhet e fabrikuara ose të manipuluar – video e falsifikuar e ndërveprimit të kryeministrit Kurti me një fermer serb – mund të kalojnë shpejt nga paqartësia digjitale në lajmin apo çështjen kryesore.¹² Në qershor të vitit të kaluar, një audio incizim u shfaq në Twitter, që supozohej se kapte një bisedë mes kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe ambasadorit të SHBA-së Jeffrey Hovenier lidhur me arrestimin e serbëve në Kosovë. Ky incizim më vonë u konfirmua se ishte një falsifikim i pamohueshëm, ku si Ambasada e SHBA ashtu edhe Qeveria e Kosovës mohuan publikisht autenticitetin e tij.¹³ Deri në momentin që histori të tilla zbardhen, dëmi i shkaktuar i perceptimit publik tashmë është bërë. Ekziston nevoja për një ekosistem të fuqishëm të kontrollit të fakteve që operon nëpër platforma mediatike, duke siguruar që keqinformimi të identifikohet dhe trajtohet përpara se të mund të përshkallëzohet. Megjithatë, përderisa kjo do të ishte një strategji efektive, është e diskutueshme nëse është e mundur pa mbështetjen e të gjithë akterëve përkatës.

Barrierat gjuhësore dhe kulturore mundësojnë përhapjen e dezinformative në Kosovë

Ndarjet gjuhësore në Kosovë pengojnë ndjeshëm aftësinë e komuniteteve të ndryshme për të sfiduar narrativat e dezinformative dhe për të kuptuar perspektivat e njëri-tjetrit. Mungesa ose njohja e dobët e të dy gjuhëve ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb krijon hendeqe informacioni, të cilat i shfrytëzojnë fushatat e dezinformimit. Për shembull, një dezinformate që në shënjestër e kishte kryeministrin e Kosovës, z. Kurti, iu desh më shumë për t’u adresuar sepse e kishte origjinën në mediat serbe, por sikur të ishte shfaqur për herë të parë në një organizatë mediatike kosovare në gjuhën shqipe, “zyra për komunikim me publikun e kryeministrit do të kishte dëgjuar menjëherë për të. Por për shkak se ishte në mediat serbe, kishte më pak ndërgjegjësime

12. Intervistë personale me këshilltarin e lartë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, 21 tetor 2024.

13. Sbunker, “Deepfake e një bisede të fabrikuar midis Hovenier dhe Kurtit, “28 qershor 2023, <https://sbunker.org/en/disinfo/deepfake-i-nje-bisede-te-pretendu-ar-mes-hovenier-dhe-kurtit/>

të menjëhershëm.”¹⁴ Këto barriera gjuhësore jo vetëm që i vonojnë përgjigjet ndaj dezinformatave, por gjithashtu u mundësohet më lehtë narrativave të mbeten të pakundërshtueshme brenda fluskulave të tyre përkatëse: “Derisa të kemi më shumë njerëz që mund të flasin gjuhët e njëri-tjetrit, është shumë më e lehtë që gjërat të keqinterpretohen”.¹⁵ Mungesa e mirëkuptimit të përbashkët në Kosovë ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb lejon që mosbesimi të vazhdojë dhe dezinformimi të lulëzojë. Prandaj, duke i dhënë përparësi mësimi të gjuhës së komunitetit tjetër dhe shkëmbimit kulturor për të kapërcyer ndarjet dhe për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë, e shton më shumë peshën se “ çiltërsia për të marrë informata edhe nga mediat e komunitetit tjetër është çelësi për korrigjimin e keqinterpretimeve.”¹⁶ Pa qasje reciproke (mediat në gjuhën shqipe dhe serbe) në media dhe narrativa, komunitetet mbeten të kufizuara në ekosistemet e tyre përkatëse të informacionit, të paaftë për të sfiduar apo verifikuar dezinformatat për palën tjetër.

Komunitetet e margjinalizuara dhe ato rurale janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dezinformimi

Fushatat e dezinformimit në Kosovë shpesh i shënjestrojnë komunitetet e margjinalizuara dhe rurale, ku qasja në mësimin dhe edukimin informativ është e kufizuar. Kjo dobësi përkeqësohet edhe më tej nga mungesa e iniciativave të synuara edukative që adresojnë nevojat specifike të këtyre komuniteteve. Përderisa qendrat urbane mund të kenë akses në punëtoritë dhe programe të edukimit mediatik, zonat rurale dhe komunitetet pakicë shpesh lihen jashtë përpjekjeve të tilla, ose nuk përfshihen në masën e duhur. Edukimi mbi të menduarit kritik dhe mësimi mediatik është thelbësor për t’iu kundërvënë këtyre sfidave dhe ato nuk duhet të kufizohen me shtrirje vetëm në shkolla, por të shtrihen në mjedise informale ku mund të përfitojnë edhe popullata e moshës më të vjetër ose më pak të arsimuara.

14. Intervistë me një zyrtar të lartë nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, tetor, 2024.

15. Ibid.,

16. Ibid.,

Dezinformimi nuk është vetëm një problem shoqëror, por edhe një kërcënim i drejtpërdrejtë për proceset politike, siç është dialogu i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Cenueshmëria e procesit të dialogut të normalizimit ndaj dezinformatave është përkeqësuar ndjeshëm nga mungesa e transparencës nga Qeveria e Kosovës. Për shembull, informacioni i dhënë nga qeveria për takimet e dialogut në Bruksel ka qenë i pakët, e që ndryshe nga praktikat e mëparshme, qeveria ende nuk ka zhvilluar një raport publik gjithëpërfshirës mbi progresin dhe rezultatet e dialogut të normalizimit. Kjo mungesë transparence shtohet më tej nga ankesat e gazetarëve në lidhje me aksesin e kufizuar në informacion dhe vonesat në komunikimet e qeverisë në lidhje me dialogun.¹⁷ Zbrazëtira të tilla jo vetëm që minojnë besimin e publikut, por gjithashtu krijojnë një mjedis ku dezinformimi mund të lulëzojë, duke mbushur boshllëkun e lënë nga narrativat zyrtare joadekuate. Për shembull, keqinterpretimet e mediave – të tilla si portretizimi i Kosovës si vend që po kryen “spastrim etnik” – dëmtojnë besimin e nevojshëm për dialog kuptimplotë. Këto narrativa jo vetëm që polarizojnë komunitetet, por edhe dobësojnë pozitën e Kosovës, pasi keqinterpretimet minojnë perceptimin e Kosovës si një shtet multi-etnik dhe funksional. Për shembull, thashethemet për mbylljen e shkollave apo spitaleve serbe në Kosovë krijuan panik, duke nxitur emigracionin dhe duke e rraskapitur komunitetin aty. Kjo minon argumentin e Kosovës për gjithëpërfshirje dhe bashkëjetesë, duke përforcuar narrativën e Serbisë për Kosovën si një shtet jofunksional. Kjo qasje e shënjestërimit të dialogut të normalizimit përmes dezinformimit u sjell dobi elitave politike, ndërkohë që ka efektin e minimit ose dobësimit të veprimit së popullatave lokale, të cilat përndryshe mund të mbështesin normalizimin. Për shembull, narrativat si “BE-ja po i bën presion Kosovës” ose “Kosova po minon të drejtat e serbëve” janë armatosur për të mbështetur kundërshtimin e arritjes së marrëveshjes.¹⁸ Ekosistemi i përgjithshëm i dezinformimit në Kosovë është ndërlikuar më shumë

17. Shih për shembull A2, “Kosovë-Serbi, dialogu vijon në Bruksel, kritika për mungesën e transparencës”, 23 tetor, 2024, <https://www.youtube.com/watch?v=qwxTs2Yrbl4>

18. Intervistë me një serb të Kosovës që punon me bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, tetor, 2024

nga mungesa e investimeve nga qeveria në procesin e pajtimit dhe bashkëpunim ndëretnik: "Shumica e aktiviteteve që bëjmë janë të mbështetura nga ambasadat apo organizatat ndërkombëtare, thjesht nuk ka mjetet financiare për këto lloj iniciativash që vijnë nga qeveria."¹⁹ Kjo mbështetje vetëm në financim nga fondet e vendeve tjera minon qëndrueshmërinë e programeve të filla, duke i lënë ato të cenushme me mundësi të ndërprerjes së veprimtarisë.

Gazetarët e Kosovës i perceptojnë disa media serbe si mjete për shpërndarjen e dezinformatave që synojnë të minojnë shtetësinë e Kosovës dhe të ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike. Ky shqetësim është përforcuar nga të dhënat nga hulumtimi i NDI-së në Kosovë që tregojnë se 79% e komunitetit serb në Kosovë mbështetet në stacionet televizive serbe për informacione ditore, me 66% që shprehin besim në këto media. Mbizotërimi i mediave serbe në formësimin e narrativave mes serbëve të Kosovës lejon që fushatat e dezinformimit të marrë vëmendje, veçanërisht kur këto media propagandojnë narrativa të përafuara me agjendat shtetërore të sponsorizuara nga Beogradi. Këto narrativa shpesh e portretizojnë Kosovën si armiqësore ndaj serbëve ose si një shtet të dështuar, duke thelluar më tej mosbesimin dhe polarizimin ndërmjet komuniteteve. Kjo përkeqësohet edhe më shumë nga mungesa e dialogut cilësor ndëretnik. Roli i dezinformimit në marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë është thellësisht i lidhur me narrativat politike dhe interesat shtetërore, me disa media serbe që shpesh ndihmojnë në përjetësimin dhe përforcimin e narrativave të qeverisë lidhur me Kosovën. Duke shfrytëzuar mediat e kontrolluara nga shteti dhe gazetarinë tabloide, qeveria serbe mban një fushatë sistematike dezinformuese që synon delegitimimin e pavarësisë së Kosovës dhe nxitjen e mosbesimit mes serbëve të Kosovës. Ajo që është më e rëndësishmja është se, qeveria serbe përdor mediat për të mbajtur një perceptim për Kosovën që nuk është i rremë, një perceptim që tregon se serbët e Kosovës për çdo ditë janë nën sulme dhe jetojnë nën represion. Sipas intervistave me gazetarët kosovarë, mediat serbe shpesh propagandojnë narrativa të përafuara me agjendën politike të Serbisë, siç është portretizimi i Kosovës si një "projekt i përkohshëm" ose "Kosova dhe Metohia.

"Këto përpjekje, sipas një gazetari të intervistuar për këtë raport, synojnë të mbjellin përçarje. Në këtë kontekst, sipas një gazetari kosovar, një portal i veçantë mediatik që bie në sy dhe e qëndron prapa me këtë agjendë është Kosovo Online, që mendohet se drejtohet nga Beogradi. Sipas gazetarit të intervistuar për këtë reportazh "Kosovo Online gjen njerëz, p.sh., një deputet nga Bundestagu Gjerman në partiën AfD, të cilët kanë qëndrime anti-kosovare dhe ata përpiqen përmes këtyre intervistave të shfaqen si të besueshëm dhe se nuk punojnë për Beogradin."²⁰ Në këtë mënyrë, disa media me një axhendë të ndërtuar për dezinformim u qasen përfaqësuesve politikë nga partitë e ekstremit të djathtë në Evropë, në mënyrë që të përforcojnë më tej narrativat e dëmshme. Kjo taktikë demonstroi se si mediat serbe përdorin zërat e jashtëm për të legjitimuar narrativat e tyre të brendshme, duke krijuar një imazh të paanshmërisë duke u shërbyer interesave shtetërore. Narrativa të tilla intensifikojnë mosbesimin midis shqiptarëve dhe serbëve, duke përkeqësuar marrëdhëniet tashmë të brishta ndëretnike dhe duke minuar përpjekjet për normalizim.

Raportimi joadekuat kontekstual nga mediat kosovare në gjuhën shqipe kontribuon në dezinformim, duke acaruar më tej marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë

Ndërveprimi ndërmjet dezinformimit dhe keqinformimit i ndërlikon marrëdhëniet ndëretnike, pasi edhe gabimet e paqëllimshme në standardet gazetareske mund të kenë efekte të dëmshme. Në Kosovë, mangësitë strukturore në praktikën mediatike, si presioni për raportim të shpejtë dhe mungesa e ekspertizës historike dhe politike në mesin e gazetarëve të rinj, kanë rezultuar në përhapjen e paqëllimshme të keqinformatave.²¹ Gazetarët kosovarë të intervistuar për këtë raport shpjegojnë se disa gazetarë kosovarë nuk arrijnë të angazhohen në mënyrë kritike ose të kontekstualizojnë përmbajtjet nga mediat serbe, shpesh duke e përkthyer fjalë për fjalë. Kjo mungesë e raportimit kontekstual mund të përjetësojë narrativa që shtrembërojnë faktet dhe përforcojnë tensionet. Presioni mbi gazetarët për të krijuar

19. Intervistë me një serb të Kosovës që punon me bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, tetor, 2024

20. Intervistë me një gazetar nga Kosova, tetor, 2024

21. Ibid.,

lajme të shpejta kontribuon në këto mangësi, siç përshkruhet nga një gazetar: "Presioni i madh është të kesh një artikull çdo dhjetë minuta".²² Këto praktika pa dashje lejojnë keqinformimin të depërtojë në diskursin publik, duke tensionuar marrëdhëniet ndëretnike duke përforcuar stereotipet dhe duke thelluar ndarjet ekzistuese.

Sipas serbëve të Kosovës të intervistuar për këtë raport, ata vërejnë se në Kosovë, mediat tradicionale shpesh i shërbejnë agjendave politike, veçanërisht në zonat rurale ku qasja në informacione të ndryshme është e kufizuar: "Mediat tradicionale kanë në shënjestër më së shumti brezat e moshës së mesme dhe të vjetër, të cilët janë bombarduar nga lajme të rreme ose tregime nxitëse."²³ Për shembull, mediat serbe, siç është Kurir, e cilësuan sulmin terrorist në Banjskë të shtatorit 2023, si një akt agresioni të paprovokuar zbatuar nga Policia e Kosovës kundër serbëve vendas. Ky portretizim e vë në theks viktimizimin, e ku presidenti Vuçiq pretendonte se serbët u vranë "pa asnjë arsye" dhe se qeveria e Kosovës po "dërgonte" zyrtar policor për të "i vranë të gjithë serbët" duke përforcuar narrativën e shtypjes kundër komunitetit serb.²⁴ Ky raportim i njëanshëm përforcon paragjykimet dhe parandalon publikun të angazhohet me perspektiva alternative. Platformat e mediave sociale, nga ana tjetër, mundësojnë përhapjen e shpejtë të narrativave sensacionale dhe shpesh të rreme, veçanërisht në mesin e grup moshave të reja. Shpesh mediat priren të formulojnë tituj provokues rreth incidenteve etnike, sepse ato fitojnë shpejt vëmendje e tërheqje online në internet. Kombinimi i këtyre platformave krijon një qark të fuqishëm reagimi ku përmbajtja përçarëse dominon si në diskursin publik ashtu edhe në perceptimet individuale, duke minuar përpjekjet për të ndërtuar besimin ndëretnik.

22. Ibid.,

23. Intervistë me një serb të Kosovës që punon me bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, tetor, 2024

24. KoSSev, "Vuçiq: Vrasja e policit nuk ishte e planifikuar, dyshojmë se një serb është vranë pasi është dorëzuar", 27 shtator 2023, <https://kossev.info/en/vucic-ubistvo-policaqica-nije-bilo-planirano-sumnja-mo-da-je-jedan-srb-in-ubijen-nakon-sto-se-predao/>

Prëfimet pozitive për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik raportohen shumë më pak, duke lejuar që narrativat negative të dominojnë

Një nga aspektet më të anashkaluar të dezinformimit në Kosovë është mungesa e lajmeve pozitive që nxjerrin në pah bashkëpunimin dhe bashkëjetesën e suksesshme ndëretnike. Serbët kosovarë të intervistuar për këtë raport ankohen për mediat kosovare që rrallë i mbulojnë këto lajme, duke u fokusuar më shumë në konflikt dhe ndarje. Ky raportim selektiv përforcon një perceptim të armiqësisë së pakapërcyeshme ndërmjet komuniteteve, edhe kur realitetet e përditshme sugjerojnë të kundërtën. Për shembull, rasti i një kontraktuesi që ndërtoi shtëpi për serbët në Komunën e Graçanicës, një projekt që nuk u raportua ndërsa lajmet se serbët po u shisnin shtëpi shqiptarëve dominonin në media. Për më tepër, shembulli i Komunës së Graçanicës ku pjesëtarët e komuniteteve, shqiptarë dhe serbe, punojnë në institucione publike dhe adresojnë incidente me bazë etnike gjithashtu raportohet më pak.²⁵ Ky çekuilibër në raportim jo vetëm që nxit dezinformimin, por gjithashtu lë mangu publikun nga narrativat që mund të frymëzojnë besim dhe bashkëpunim. Inkurajimi i mediave për t'u fokusuar në lajme pozitive ndëretnike mund të ndihmojë në kundërshtimin e ndikimit përçarës të dezinformimit.

Fushatat e dezinformimit që synojnë marrëdhëniet ndëretnike janë veçanërisht tinëzare sepse ato minojnë bazën e përpjekjeve për pajtim

Ekspertët e intervistuar për këtë raport vërejnë se fushata të tilla shpesh i përshkruajnë iniciativat e pajtimit si komplete të orkestruara nga akterë të huaj, gjë që dekurajon pjesëmarrjen e vendorëve. Mungesa e raportimit pozitiv për bashkëpunimin e suksesshëm ndëretnik e pengon edhe më tej procesin e pajtimit. Ekziston nevoja që mediat shqip dhe serbe të fokusohen në narrativa konstruktive për t'iu kundërvënë këtyre efekteve përçarëse.

25. Intervistë me një zyrtar nga Komuna e Graçanicës, tetor, 2024

Ekziston rrezik i veçantë i përdorimit të frikës/miteve tashmë të krijuara për përhapjen e dezinformatave

Këto narrativa janë projektuar për të krijuar dyshime dhe frikë, duke i bërë ato veçanërisht tinëzare. Për shembull, dezinformatat nga disa burime shqiptare të Kosovës e e portretizojnë Serbinë se është duke e përdorur veriun e Kosovës për të krijuar një Republika Srpska ose si një qendër për krimin e organizuar. Anasjelltas, narrativat serbe pretendojnë se Kosova kërkon të i dëbojë serbët dhe të krijojë një shtet etnikisht të pastër shqiptar. Pretendime të tilla shfrytëzojnë paaftësinë e individëve për të verifikuar motivet, duke i bërë ato të vështira për t'u verifikuar dhe për t'u hedhur poshtë. Ekspertët theksojnë se si këto rrëfime janë veçanërisht efektive, sepse ato rezonojnë me frikën ekzistuese. Kjo përsëritje e vazhdueshme e motiveve përçarëse parandalon dialogun konstruktiv dhe i mban komunitetet të ngulitura në mosbesim të ndërsjellë. Rrëfimet e zhvendosin vëmendjen larg fakteve dhe politikave në qëllime të paprovueshme, gjë që përforcon dyshimin dhe armiqësinë. Ndarja fizike dhe sociale e komuniteteve etnike në Kosovë e përkeqëson efektivitetin e dezinformimit. Ndërveprimi i kufizuar ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve do të thotë se individët rrallë kanë mundësi të sfidojnë stereotipet ose të hedhin poshtë narrativat përçarëse përmes marrëdhënieve personale. Mungesa e dygjuhësisë e rrënjos më tej këtë ndarje, pasi komunitetet konsumojnë tregime mediatike krejtësisht të ndryshme që përforcojnë perceptimet e tyre. Të rinjtë perceptohen si veçanërisht të cenueshëm, pasi rriten në mjedise pa ndërveprim ndëretnik. Pak shkolla ose programe jashtëshkollorë ofrojnë mundësi për bashkëveprim të fëmijëve nga komunitete të ndryshme. Pa këto lidhje personale, paragjykimet kanë më shumë gjasa të vazhdojnë, duke i lënë individët të varur nga media dhe dezinformata për të i kuptuar "ata".

Roli i thashethemeve lokale në minimin e marrëdhënieve ndëretnike në përgjithësi është nënvlerësuar

Përderisa mediat dhe udhëheqësit politikë shpesh tërheqin vëmendjen si nxitës të dezinformimit, thashethemet lokale – tregime joformale që shpërndahen në mjediset e përditshme – luajnë një rol kritik, por shpesh të anashkaluar në jetësimin e mosbesimit dhe ndarjeve ndëretnike në Kosovë. Këto

shkëmbime në dukje të padëmshme, të përhapura në kafene, mbledhi të komunitetit dhe hapësira të tjera informale, përforcojnë narrativat e dëmshme, nxisin stereotipet dhe kontribuojnë në fragmentimin e shoqërisë. Intervistat me udhëheqësit e lartë komunalë në Kosovë, tregojnë se thashethemet e tilla shpesh nuk e kanë qëllimin dashakeq apo agjenda e qëllimshme, por ato nxisin frikë dhe urrejtje thjesht sepse përsëriten gjerësisht dhe pranohen si të vërteta, siç theksohet nga një zyrtar i lartë nga Komuna e Graçanicës: "Më shumë se 90% e këtyre tregimeve informale rrjedhin nga mosdija apo keqinformimi dhe jo nga keqdashja e qëllimshme".²⁶ Lidhja emocionale dhe besimi i natyrshëm në komunikim në komunitet i bëjnë thashethemet lokale veçanërisht të rrezikshme. Për shembull, ka pasur raste në Komunën e Graçanicës ku vjedhjet ndërmjet individëve të së njëjtës etni i janë atribuar në mënyrë të rreme pjesëtarëve të një grupi tjetër etnik. Këto shtrembërime nxitën dyshime dhe përforcuan stereotipe të dëmshme, duke përkeqësuar ndarjet ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb të Kosovës. Thashetheme të tilla fitojnë vëmendje në kontekste ku ndarjet sociale dhe fizike kufizojnë ndërveprimet personale midis grupeve etnike. Në këto mjedise, individët mbështeten shumë në thashethemet dhe tregimet joformale për të krijuar kuptimin e tyre për komunitetet e tjera, duke i bërë thashethemet një mjet efektiv për përjetësimin e stereotipeve dhe mosbesimit.

Mungesa e koordinimit dhe konsultimit efektiv të Qeverisë së Kosovës me BE-në dhe NATO-n për veprimet e ndërmarrja në veri të Kosovës dhe dominimi i dezinformatave në veri të Kosovës jo vetëm që i përkeqëson tensionet, por gjithashtu rezulton në heshtjen e shqetësimeve legjitime dhe përvojave të përjetuara të komunitetit serb të Kosovës

Me fjalë të tjera, në këtë kontekst të përgjithshëm të tensioneve të shtuara ndëretnike në veri të Kosovës dhe niveleve të konsiderueshme të dezinformatave, rastet e mundshme të dhunës së ushtruar ndaj komunitetit serb të Kosovës në veri apo jug, disi humbasin në këtë kaos. Kjo është veçanërisht alarmante sepse i mohon këtë komunitet një rrugë

26. Ibid.,

thelbësore për të shprehur shqetësimet e tyre dhe për të kontribuar në adresimin e sfidave me të cilat përballen. Mungesa e kanaleve të tilla rrezikon të largojë më tej popullatën serbe të Kosovës, të përforcojë mosbesimin e tyre në institucione dhe të thellojë ndarjet brenda shoqërisë. Në këtë mjedis kaotik të tensioneve të shtuara dhe dezinformimit të pakontrolluar, zërat që avokojnë për integrim dhe për të nxitur një shoqëri multietnike në Kosovë – si nga perspektiva liberale ashtu edhe brenda komunitetit serb – janë minuar ndjeshëm. Këta zëra, si nga veriu ashtu edhe nga jugu, përballen me marginalizim në rritje, pasi atmosfera e polarizuar zvogëlon aftësinë e tyre për të promovuar dialogun, bashkëpunimin dhe bashkëjetesën.

INë këtë mjedis sfidues, shoqëria civile në veri të Kosovës do të luaj rol vendimtar. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë të pozicionuara në mënyrë unike për të vepruar si ndërmjetës, duke kapërcyer hendekun midis komunitetit dhe institucioneve. Duke i komunikuar në mënyrë efektive përvojat dhe shqetësimet e komunitetit serb të Kosovës në mënyrë konstruktive, ata mund të ndihmojnë që këto zëra të mos humbasin në zhurmën më të gjerë të dezinformatave. Për më tepër, shoqëria civile mund të nxisë dialogun dhe të eksplorojë rrugët për bashkëpunim me institucionet publike në mënyrë që të eksplorojë zgjidhjet e mundshme që adresojnë shqetësimet lokale duke kontribuar në një mjedis më gjithëpërfshirës dhe më stabil në veri të Kosovës. Në anën tjetër, institucionet publike në Kosovë duhet të bëjnë dy gjëra. Së pari, ata duhet të komunikojnë në mënyrë më efektive masat e tyre në veri të Kosovës, si dhe të komunikojnë me komunitetet lokale me qasje nga poshtë-lart.²⁷ Së dyti, ata duhet të rrisin kontaktin e tyre me komunitetin serb të Kosovës dhe të rrisin

27. Intervistë me një përfaqësues nga Zyra e Këshillit të Evropës në Kosovë, tetor 2024

numrin e policëve që flasin gjuhën serbe që punojnë në veri, si masë e përkohshme dhe urgjente derisa qeveria të mund të rikthejë numrin e policëve nga komuniteti serb i Kosovës në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicën Veriore. Së fundi, ura e komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile apo palëve tjera relevante që mund të trajtojnë çështjen e dezinformimit ka të bëjë edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Vetëm 50% e dokumenteve janë të publikuara, ndërsa të tjerat jo, gjë që lë hapësirë për mos marrje të përgjigjes dhe rrjedhimisht të prirur për keqinterpretim.²⁸

Thashethemet lokale shpesh shërbejnë si përforcues informalë për fushata më të gjera dezinformuese të orkestruara nga aktorë politikë ose mediatikë. Për shembull, sipas një zyrtari të lartë nga Komuna e Graçanicës, narrativat që vënë në pikëpyetje paanshmërinë dhe efektivitetin e Policisë së Kosovës – të shpërndara përmes mediave formale – përmenden shpesh në diskutimet joformale. Ky përforcim joformal jo vetëm që zgjeron shtrirjen e dezinformimit, por gjithashtu i jep atij një frymë besueshmërie, pasi ai vjen nga burime të besuara të komunitetit. Për shembull, një shfaqje teatrale në Ulpiana Fest në Graçanicë u keqinterpretua në mediat sociale si një sulm fetar, duke shkaktuar tensione lokale. Thashethemet joformale u përhapën me shpejtësi, duke e kthyer një ngjarje të padëmshme kulturore në një provokim të perceptuar. Ndërhyrja e shpejtë nga autoritetet lokale ndihmoi në qetësimin e situatës, por incidenti nënvizon se sa lehtësisht thashethemet mund të përkeqësojnë tensionet.²⁹

28. Intervistë me një përfaqësues nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, tetor 2024

29. Ibid.,

Gjysmë të vërtetat, realitetet paralele dhe dezinformatat

Dezinformimi është një kërcënim i mirënjohur për normat demokratike, paqen dhe kohezionin shoqëror, por gjysmë të vërtetat – deklaratat me mungesë konteksti ose që kombinojnë elemente të faktit me informacione mashtruese ose të hequra – paraqesin një sfidë edhe më të madhe, veçanërisht në kontekste të brishta ndëretnike si Kosova. Këto gjysmë të vërteta mbartin pamjen e besueshmërisë, duke i bërë ato më të vështira për t'u zbuluar dhe më shumë gjasa për të fituar pranim të gjerë. Për dallim nga dezinformimi, i cili shpesh mund të përgënjestrohet plotësisht me prova, gjysmë të vërtetat shfrytëzojnë paragjykimet kognitive, shmangin shqyrtimin dhe krijojnë konfuzion, duke përkeqësuar përfundimisht mosbesimin dhe ndarjet. Gjysmë të vërtetat e nxjerrin fuqinë e tyre nga besueshmëria e perceptuar e tyre. Duke futur thelbin e të së vërtetës brenda një narrative mashtruese, këto deklarata anashkalojnë skepticizmin që mund të provokojnë gënjeshttrat e plota. Për shembull, pjesëmarrësit në fokus grupet theksuan një rast ku një vendim i qeverisë në lidhje me kufizimet e importit të mallrave serbe ishte keqinterpretuar si i zgjidhur

plotësisht. Në realitet, vetëm disa vendkalime ishin përfshirë, duke lënë çështje kyçe të pazgjidhura. Kjo saktësi e pjesëshme lejoi që tregimi të fitonte në peshë, duke i mashtruar të dy komunitetet dhe duke nxitur pakënaqësi në mesin e serbëve të Kosovës të cilët mendonin se vendimi ishte keqinterpretuar.³⁰ Kjo finesë mashtruese mundëson që gjysmë të vërtetat të përhapen gjerësisht, veçanërisht përmes rrjeteve dhe kanaleve mediatike të besuara. Ndryshe nga dezinformatat flagrante, të cilat mund të ngrenë menjëherë mund të ndezin dritën e kuqe, gjysmë të vërtetat kanë më pak gjasa të vihen në pikëpyetje, veçanërisht nga individë që nuk kanë njohuri për median ose qasje në perspektiva alternative. Pjesëmarrësit në diskutime vunë në dukje se burimet e besuara që ndajnë tregime jo të plota e zgjerojnë pa dashje shtrirjen e tyre, pasi audiencia rrallë vlerëson në mënyrë kritike informacionin nga këto burime.

30. Intervistë me një gazetar serb të Kosovës, tetor 2024

NGJARJE/ LAJME	PERCEPTIMI I PËRGJITHSHËM I SHQIPTARËVE TË KOSOVËS	PERCEPTIMI I PËRGJITHSHËM I SERBËVE TË KOSOVËS
SULMI NË BANJSKA	Sulmi terrorist nga trupat paramilitare	Glorifikimi i sulmuesve si heronj
AKS	Një kërcënim për integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës si "Republika Srpska" (53% shqiptarë dhe 37% serbë)	Dëshmi e keqbesimit të Kosovës
MASAT E QEVERISË NË VERI	Mekanizmi për zbatimin e ligjit	Përpijekjet për spastrim etnik të komunitetit serb
DIALOGU I NDËRMJETËSUAR NGA BE-ja	BE-ja po i bën presion Kosovës	BE-ja po minon të drejtat e serbëve
NGJARJET KULTURORE	Nuk ka reagim.	Kërcënime ndaj fesë ortodokse

Ndikimi psikologjik dhe emocional i gjysmë të vërtetave gjithashtu i bën ato jashtëzakonisht të rrezikshme. Duke u përafuar me paragjykimet ekzistuese, këto tregime provokojnë reagime të forta emocionale si frika ose zemërimi, të cilat lënë në hije diskursin racional. Titujt sensacionalë ose faktet e përshtatura në mënyrë selektive nxisin armiqësi midis komuniteteve, duke thelluar ndarjet dhe duke përforcuar stereotipet. Për shembull, raportet mashtruese gjatë momenteve të tensionuara, si ato që lidhen me incidentet në veri të Kosovës, shpesh paraqesin ngjarje në mënyra që rrisin armiqësinë etnike. Përkeqësimi i çështjes e ndërlikon kundërvënien ndaj gjysmë të vërtetave. Për dallim nga gënjeshttrat e qarta, të cilat mund të zbulohen lehtë, gjysmë të vërtetat kërkojnë përgjigje të nuancuara që adresojnë si aspektet e sakta ashtu edhe ato mashtruese. Ky kompleksitet shpesh rezulton në përpjekje të vonuara ose joefektive për zbulim. Për më tepër, korrigjimet rrallë arrijnë të njëjtin nivel shtrirjeje ose rezonimi si informacioni mashtrues origjinal, duke i lënë komunitetet të përballen me efektet e vazhdueshme të mosbesimit dhe keqinformimit. Pasojat afatgjata të gjysmë të vërtetave janë veçanërisht të dëmshme. Ekspozimi i përsëritur minon besimin në media, institucionet, madje edhe proceset e pajtimit. Në Kosovë, ku marrëdhëniet ndëretnike janë të brishta, ky erozion i besimit është thellësisht i dëmshëm. Pjesëmarrësit në diskutimet në fokus grupe të organizuara për këtë raport theksuan se gjysmë të vërtetat kanë kontribuar në krijimin e “realiteteve paralele” ku komuniteti serb dhe ai shqiptar konsumojnë narrativa krejtësisht të ndryshme për të njëjtat ngjarje. Ky fragmentim jo vetëm që thellon ndarjet, por edhe pengon dialogun dhe pajtimin kuptimplotë. Ndonëse disa argumentojnë se dezinformimi i plotë, me

gënjeshttrat e tij të qëllimshme, përbën një rrezik imediat për shkak të potencialit të tij për të nxitur dhunën, rreziku nga lajmet gjysmë të vërteta qëndron në natyrën e tyre tinëzare. Ato destabilizojnë shoqëritë gradualisht, duke minuar themelet e besimit të nevojshëm për bashkëjetesë. Adresimi i kësaj sfide kërkon ndërhyrje të përshtatura, të tilla si nxitja e edukimit mediatic, promovimi i iniciativave të verifikimit të fakteve dhe inkurajimi i dialogut ndërmjet komuniteteve për të zbutur ndikimin e mprehtë por të përhapur të gjysmë të vërtetave. Në kontekste të brishta siç është Kosova, gjysmë të vërtetat nuk janë thjesht mashtruese; ato janë gërryese. Ata lulëzojnë në hijet e paqartësisë, duke shfrytëzuar përçarjet në shoqëri dhe duke gërryer besimin e nevojshëm për të ndërtuar një të ardhme paqësore, multietnike. Njohja dhe adresimi i rrezikut të tyre unik është thelbësor për të nxitur qëndrueshmërinë ndaj taktikave manipuluese të dezinformimit.

Mungesa e transparencës institucionale krijon terren të përshtatshëm që dezinformimi të lulëzojë në Kosovë. Për shembull, kur institucionet publike nuk arrijnë të ndajnë në mënyrë proaktive informacione të sakta, veçanërisht për zhvillimet në veri të Kosovës apo zonat me shumicë serbe, ato lënë hapësirë për spekulime dhe manipulime. Titujt mashtrues, të krijuar për të tërhequr klikime, shpesh paraqesin informacione që ndryshojnë ndjeshëm nga përmbajtja e artikujve. Kjo praktikë e mban gjallë dezinformimin publik dhe ushqen narrativa përçarëse. Dezinformimi përdoret shpesh si një mjet për të penguar përparimin në dialogun e normalizimit të lehtësuar nga BE.

Dinamika e diasporës dhe rritja e dezinformatave

Komuniteti i diasporës shpesh shërben si lidhje jetike midis atdheut të tyre dhe vendeve pritëse, duke ndikuar në perceptimet, diskursin publik dhe madje edhe politikëbërjen. Në kontekstin e Kosovës, megjithatë, rrjetet e diasporës janë bërë të forcuara të rëndësishëm të dezinformatave, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike dhe marrëdhëniet e përgjithshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve të lehtësuara nga Bashkimi Evropian (BE). Këto dinamika janë formuar nga distanca fizike dhe emocionale e diasporës nga realitetet në terren, konsumimi i narrativave sensacionale dhe tendenca e tyre për të adoptuar pozicione të radikalizuara.

Një karakteristikë kryesore e dezinformimit të drejtuar nga diaspora është tendenca drejt ekstremizmit. Siç vërehet në pjesëmarrësit në fokus grupe, pjesëtarët e diasporës shpesh miratojnë qëndrime më radikale sesa ata që jetojnë në Kosovë. Ky fenomen nuk është i ndarë vetëm për Kosovën, por është qëndron në shumë komunitete të diasporës të popujve tjerë në mbarë botën, ku distanca nga realitetet e përditshme nxit pikëpamje të idealizuara ose kontradiktore. Në rastin e Kosovës, disa pjesëtarë të diasporës amplifikojnë narrativat e polarizuara në mediat sociale, shpesh përmes llogarive anonime pa kurrfarë përgjegjshmërie apo transparencë. Këto rrëfime, ndonëse nuk formojnë domosdoshmërisht diskursin drejtpërdrejt, shërbejnë si kuvende me mendime të njëjta që zmadhojnë ndarjet ekzistuese.

Siç u theksua në diskutimin e fokus grupeve për këtë raport dhe të mbështetur nga analizat rajonale, anëtarët e diasporës shpesh miratojnë qëndrime më radikale sesa banorët e vendeve të tyre. Kjo është veçanërisht e dukshme në Ballkanin Perëndimor, ku ankesat historike dhe mosmarrëveshjet dypalëshe, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, krijojnë terren të përshatshëm për narrativa polarizuese. Kjo është e vërtetë edhe për diasporën shqiptare dhe serbe. Për shembull, komuniteti i diasporës serbe duket se konsumojnë shpesh dezinformata që e cilësojnë Kosovën si në thelb armiqësore ndaj serbëve ose anasjelltas, me narrativat që

pretendojnë se Kosova kërkon të pastrojë veriun etnikisht nga komunitet serb, e të cilat mbeten të përhapura. Për shembull, narrativi se ndalimi i dinarit serb si monedhë qarkullimi nga Kosova është pjesë e një strategjie më të gjerë për të dëmtuar serbët u përhap gjerësisht nga rrjetet e diasporës serbe, duke intensifikuar mosbesimin. Nga ana tjetër, diaspora shqiptare duket se konsumon shpesh dezinformata që e cilësojnë dialogun e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si tejet asimetrik, duke i shërbyer vetëm interesit të Serbisë, ku çdo marrëveshje e Kosovës shpesh shihet si koncesion. Për shembull, ka pasur numër të madh të dezinformatave të konsumuara dhe, në disa raste, të propaganduara nga komunitetet e diasporës në platformat e mediave sociale në lidhje me Asociacionin e Komunave me shumicë Serbe (AKS), si diçka që i imponohet Kosovës të themelojë një entitet tjetër të formatit si Republika Srpska. Diskutimet në fokus grupe dhe intervistat me ekspertë tregojnë se komuniteti i diasporës nuk është plotësisht në dijeni për kornizën ligjore dhe politike në Kosovë që rregullon të drejtat e komuniteteve joshumicë. Ky radikalizim etno-politik nxitet më tej nga mungesa e përvojës së drejtpërdrejtë. Pjesëtarët e diasporës shpesh mbështeten në media të shtrembëruara politikisht ose në media të kontrolluara nga shteti për informacion. Për shembull, rrjetet e diasporës serbe shpërndajnë gjerësisht dezinformatat që vijnë nga media të mbështetura nga shteti si Russian Sputnik Srbija, e cila e portretizon Kosovën si një shtet të dështuar dhe udhëheqësit e saj si marioneta të fuqive perëndimore, dhe Perëndimin si duke punuar kundër interesit serb.

Platformat e mediave sociale shërbejnë si drejtues të fuqishëm për rolin e diasporës në përhapjen e dezinformatave. Pjesëtarët e diasporës shpesh ndajnë përmbajtje që ndërthur të vërteta të pjesëshme me pretendime nxitëse. Raporti i fundit i monitorimit të mediave theksoi shpërndarjen e narrativave që e cilësojnë Kosovën si një kërcënim ushtarak pas vendimit të SHBA-së për t'i shitur Kosovës sistemet e raketave antitank Javelin. Pretendime të tilla, ndonëse kanë pak lidhje me ngjarje aktuale, u

ekzagjeruan për ta përshkruar Kosovën si duke u përgatitur për konflikt etnik, duke i tensionuar më tej marrëdhëniet ndëretnike.³¹ Në mënyrë të ngjashme, rrjetet e diasporës i rrisin fushatat e dezinformimit rajonal dhe gjeopolitik. Narrativat e mbështetura nga Rusia, për shembull, shfrytëzojnë ndarjet ekzistuese duke e portretizuar Serbinë si viktimë të kompleteve perëndimore dhe Kosovën si një përfaqësuese të "agresionit të NATO-s". Këto narrativa rezonojnë fuqishëm brenda komuniteteve të diasporës, ku ato riciklohen dhe lokalizohen përmes mediave sociale dhe kanaleve të komunitetit. Një shembull i prerë është përgjigja ndaj sulmit në

